



Në pajtim autorizim e dhëna nenin 63, 64.2 pika (i) dhe 106 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe 26 të Ligjit nr. 03/L-072 të për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 08.11.2017, nxjerrë këtë:

VENDIM

Për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Kuvendet Komunale

- I. Pas përfundimit të të gjitha procedurave në vendvotim dhe në Qendrën e Numërimit dhe të Rezultateve si dhe kur të gjitha vërejtjet që u përkasin procesit të votimit dhe numërimit janë vendosur nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa dhe nga Gjykata Supreme e Kosovës, KQZ shpall Rezultatet Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Kuvendet Komunale, të mbajtura më datën 22 tetor 2017.
- II. Nëse kandidatët brenda një subjekti politik kanë numër të barabartë të votave, atëherë mandatin do ta fitoj kandidati me numër rendor më lartë i renditur, në bazë të listës së certifikuar.
- III. Afati për ankesë fillon të rrjedh nga data 09.11.2017 prej orës 12:00.
- IV. Rezultatet e Zgjedhjeve për kuvendet komunale si në pikën I i janë bashkangjitur këtij vendimi, dhe janë pjesë përbërëse e tij.
- V. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 08.11.2017

Valdete Daka

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve